



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 3926 prot.

Himarë, më 15.07. 2024

URDHËR

Nr. 279, datë 15.07.2024

PËR

**“PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË  
HIMARË PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA  
SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE MATERIALEVE EDUKUESE ZGJEDHORE”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në pikën 3 të nenit 22, të ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, “Kodit Zgjedhor”, udhëzimit nr.6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, si dhe Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Nr.244 datë 05.07.2024 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”, neni 1 “Caktimin e datës 4 Gusht 2024, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”;

URDHËROJ:

1. Si vende të afishimit të materialeve edukuese dhe informuese, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar, caktohen ambjentet pranë zyrave të njësive administrative të Bashkisë Himarë.

2. Si vende të afishimit të materialeve propagandistike zgjedhore përcaktohen vendet publike në territorin e bashkisë deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.

Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.

Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik.



Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.

3. Ngarkohet policia bashkiake dhe administrata e bashkisë për garantimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër.

4. Ngarkohet specialisti i transparencës dhe i konsultimit publik për publikimin e këtij urdhri në faqen e internetit të bashkisë brenda 24 orësh nga miratimi i tij.

5. Ngarkohet drejtorja juridike për njoftimin e një kopje të këtij urdhëri Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet brenda 24 orësh nga miratimi i tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

Arqilea Bollano

